

URDHËR
Nr. 250, datë 1.6.2022

PËR PËRDITËSIMIN E URDHRIT TË MINISTRIT NR. 72, DATË 2.3.2017,
“PËR MIRATIMIN E LËNDËVE VEPRUESE NË PËRMBAJTJE TË PMB-ve”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar; si dhe të pikës 6.3, të kreut VII, të vendimit nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe sipas propozimit të strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar, bëhet përditësimi me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) Në listën 2, shtohen 3 (tri) lëndë vepruese, nga të cilat, 1 (një) lëndë vepruese bazike dhe 1 (një) lëndë vepruese me rrezik të ulët, bashkëlidhur këtij urdhri.

b) Rinovohen regjistrimet për 2 (dy) lëndë vepruese, nga të cilat, 1 (një) lëndë vepruese me rrezik të ulët, bashkëlidhur këtij urdhri.

c) Zgjatën afatet e regjistrimit për 83 (tetëdhjetë e tre) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri.

ç) Hiqet 1 (një) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ky përditësim të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.

3. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Frida Krifca

1. NË LISTËN 2 SHTOHEN 3 (TRI) LËNDË VEPRUESE, SI MË POSHTË:

1.1 LËNDË VEPRUESE *Beauveria bassiana* strain 203

Nr.	Emri i zakonshëm dhe nr. i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Aplikant	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	Beauveria bassiana strain 203 Nr.: CBS 121097	Nuk aplikohet	Niveli maksimal i beauvericinës: 80 µg/kg në produktin e formuluar.	GlenBiotech	19.4.2022	18.4.2032	Do të lejohet vetëm përdorim në palma zbukuruese. Për zbatimin e parimeve uniforme, konkluzionet e raportit të rinovimit për <i>Beauveria bassiana</i> strain 203 dhe, në veçanti shtojcat I dhe II

							të tij, të merren në konsideratë. T'u kushtohet vëmendje e veçantë: a) nivelit maksimal të metabolitit <i>beauvericin</i> në produktin e formuluar; b) mbrojtjes së operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh që specia <i>Beauveria bassiana</i>, pavarësisht nga lloji, është një alergjik i mundshëm i njeriut, si nga ekspozimi i lëkurës ashtu edhe nga thithja, dhe për këtë arsye pajisjet e duhura mbrojtëse personale të përfshihen si kusht përdorimi.
--	--	--	--	--	--	--	--

1.2 LËNDA VEPRUESE ME RREZIK TË ULËT *Spodoptera exigua multicapsid nucleopolyhedrovirus* (*SeMNPV*), *isolati BV-0004*

Nr.	Emri i zakonshëm dhe nr. i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Aplikant	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	Spodoptera exigua multicapsid nucleopolyhedrovirus (<i>SeMNPV</i>), <i>isolati BV-0004</i>	Nuk aplikohet	Përmbajtja e virusit në përbërësin lëndës teknike, i prodhuar si material teknik i izoluar, duhet të jetë së paku 2×10^{11} trupa/gr	Andermatt Biocontrol Suisse AG	18.4.2022	18.4.2037	Për zbatimin e parimeve uniforme, konkluzionet e raportit të rinovimit për <i>Spodoptera exigua multicapsid nucleopolyhedrovirus</i> (<i>SeMNPV</i>), <i>isolate BV-0004</i> dhe, në veçanti shtojcat I dhe II të tij, të merren në konsideratë. T'u kushtohet vëmendje të veçantë: - mirëmbajtjes së rreptë të kushteve mjedisore, në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kufijve të ndotjes mikrobiologjike; - mbrojtjes së operatorëve dhe të punëtorëve, duke marrë parasysh që

							mikroorganizmat në vetvete konsiderohen si sensibilizues të mundshëm, duke siguruar që pajisjet e përshtatshme mbrojtëse personale të përfshihen si kusht përdorimi. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e nevojshme.
--	--	--	--	--	--	--	--

1.3. LËNDA VEPRUESE BAZIKE *Chitosan*

Nr.	Emri i zakonshëm dhe nr. i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Aplikant	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	Chitosan CAS No: 9012-76-4 EC No: 618-480-0	Emri kimik (jo IUPAC): poly[4-O-(2-acetamido-2-deoxy-β-D-glucopyranosyl)-2-amino-2-deoxy-β-D-glucopyranose]	≥ 85% chitosan. Metale të rënda: max. 20 mg/kg.	KitoZyme	11.4.2022	-----	Chitosan do të përdoret në përputhje me kushtet specifike të përfshira në konkluzionet e raportit të rishikimit për chitosan, dhe në veçanti Shtojcat I dhe II të tij.

2. RINOVHEN REGJISTRIMET (RIREGJISTRIM) PËR LËNDËT VEPRUESE, SI MË POSHTË:

2.1 LËNDA VEPRUESE *Bifenazate*

Nr.	Emri i zakonshëm dhe nr. i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	Bifenazate CAS Nr: 149877-41-8 CIPAC Nr: 736	Isopropyl 2-(4-methoxybiphenyl-3-yl)hydrazinoformate	≥ 980 g/kg. Tolueni është një shqetësim toksikologjik dhe nuk duhet të kalojë 0,7 g/kg në materialin teknik	1.7.2022	30.6.2037	Do të autorizohen vetëm përdorimet në kulturat jo të ngrënshme në serra. Për zbatimin e parimeve uniforme, të merren parasysh konkluzionet e raportit të rinovimit për <i>Bifenazate</i> dhe, në veçanti shtojcat I dhe II të tij. T'u kushtohet vëmendje e veçantë, për: - mbrojtjen e operatorëve dhe të punëtorëve, duke siguruar që kushtet e përdorimit përfshijnë

						aplikimin e pajisjeve të përshatshme mbrojtëse personale; - rrezikun për bletët dhe insektet për pllenim në serra. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e nevojshme.
--	--	--	--	--	--	--

2.2. LËNDA VEPRUESE ME RREZIK TË ULËT *Metarhizium brunneum* strain Ma 43 (më parë *Metarhizium anisopliae* var. *anisopliae* strain BIPESCO 5/F52)

Nr.	Emri i zakonshëm dhe nr. i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	Metarhizium brunneum strain Ma 43	Nuk aplikohet	Jo papastërti relevante	1.5.2022	30.4.2037	Për zbatimin e parimeve uniforme, konkluzionet e raportit të rinovimit për <i>Metarhizium brunneum</i> strain Ma 43 dhe, në veçanti shtojcat I dhe II të tij, të merren në konsideratë.

3. ZGJATEN AFATET E REGJISTRIMIT PËR LËNDËT VEPRUESE, SI MË POSHTË:

- Deri më 30 prill 2023:

1. Ziram
2. Pseudomonas chlororaphis strain MA 342
3. Mepanipyrim
4. Clodinafop
5. Pirimicarb
6. Rimsulfuron
7. Triticonazole
8. Cyprodinil
9. Fosetyl
10. Trinexapac
11. Dichlorprop-P
12. Metconazole
13. Pyrimethanil
14. Triclopyr
15. Metrafenone
16. *Bacillus subtilis* (Cohn 1872) strain QST 713
17. Spinosad
18. *Bacillus thuringiensis* subsp. *aizawai* strain ABTS-1857 and strain GC-91
19. *Bacillus thuringiensis* subsp. *israeliensis* (serotype H-14) strain AM65-52
20. *Bacillus thuringiensis* subsp. *kurstaki* strain ABTS 351, strain PB 54, strain SA 11, strain SA 12, strain EG 2348
21. *Beauveria bassiana* strain ATCC 74040, strain GH4
22. *Cydia pomonella* Granulovirus (CpGV)
23. *Pythium oligandrum* strain M1
24. *Trichoderma atroviride* (formerly *T. harzianum*) strain T11

25. *Trichoderma harzianum* strain T-22, strain ITEM 908
26. *Trichoderma asperellum* (formerly *T. harzianum*) strain ICC012, strain T25, strain TV1
27. *Trichoderma gamsii* (formerly *T. viride*) strain ICC080

28. Abamectin

29. Fenpyroximate

30. Malathion

Gjithsej: 30 lëndë vepruese.

- Deri më 31 maj 2023:

1. Flurochloridone

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- Deri më 30 qershor 2023:

1. Metam

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- Deri më 31 korrik 2023:

1. Phenmedipham

2. S-metolachlor

3. Milbemectin

4. Ethephon

5. Captan

6. Folpet

7. Formetanate

8. Dimethomorph

9. Metribuzin

10. Propamocarb

11. Pirimiphos-methyl

12. Beflubutamid

13. Bentiavalicarb

14. Boscalid

15. Fluoxastrobin

16. Prothioconazole

17. Aclonifen

18. Metazachlor

19. Proquinazid

Gjithsej: 19 lëndë vepruese.

- Deri më 31 gusht 2023:

1. Acetic acid

2. Aluminium ammonium sulphate

3. Aluminium silicate

4. Calcium carbide

5. Ethylene

6. Extrakt nga bima e çajit

7. Fat distillation residues (mbetjet e distilimit të dhjemit)

8. Fatty acids (Acidet yndyrore) C7 to C20

9. Gibberellic acid

10. Gibberellin

11. Hydrolysed proteins (proteinat e hidrolizuara)

12. Iron sulphate (Sulfat hekuri)

13. Plant oils/clove oil (vajra bimore/vaj karafili)
14. Plant oils/rape seed oil (vajra bimore/vaj kolze)
15. Plant oils/spear mint oil (vajra bimore/vaj menteje shtize)
16. Pyrethrinat
17. Quartz sand (rërë kuarci)
18. Fish oil (vaj peshku)
19. Repellents by smell of animal or plant origin/sheep fat (repelentë nga nuhatja me origjinë shtazore ose bimore/dhjamë dele)
20. Straight Chain Lepidopteran Pheromones (feromonet e lepidopterëve me zinxhir të linear)
21. Urea
22. Magnesium phosphide
23. Cymoxanil
24. Dodemorph
25. 2,5-Dichlorobenzoic acid methylester
26. Metamitron
27. Sulcotrione
28. Tebuconazole

Gjithsej: 28 lëndë vepruese.

- Deri më 30 prill 2024:

1. Spirotetramat

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- Deri më 30 qershor 2024:

1. L-ascorbic acid

2. Spinetoram

Gjithsej: 2 lëndë vepruese.

- Deri më 31 gusht 2024:

1. Flubendiamide

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

TOTALI: 83 (tetëdhjetë e tre) lëndë vepruese.

4. HIQEN LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

1. Sulfoxaflor.

- Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *sulfoxaflor*, brenda datës 19 nëntor 2022;

- Heqja nga tregu i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *sulfoxaflor*, të përfundojë brenda datës 19 maj 2023.

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.